



Vlerësim i gjendjes së minoriteteve në Kosovë (në periudhën kohore prej marsit 2001 deri në gusht 2001)

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport, i teti me rradhë në serinë e raporteve të përpiluara nga UNHCR-ja dhe OSBE-ja, ka për qëllim t'ju jap një pasqyrë të problemeve me të cilat ballafaqohen sot bashkësitë e minoriteteve në Kosovë. Duke nxjerrur informata nga rrjeti i gjerë në terren të organizatave kontribuese të këtij raporti, krahas informatave të marra nga burime të ndryshme, ne kemi për qëllim që t'i ofrojmë lexuesit një pasqyrë reale dhe gjithëpërfshirëse përkitazi me përvojat ditore me të cilat ballafaqohen këto bashkësi. Shpresojmë se ky raport do të shiqohet si një koment informativ dhe objektiv, koment ky i pavarur nga çfarëdo lloj ideologjie e veçantë apo agjende tjetër nga ajo që parashikohet nga mandatet respektive të institucioneve tona e që është përkrahja dhe mbrojtja e atyre njerëzve të drejtat e të cilëve janë shkelur dhe vazhdojnë të shkelen edhe më tutje. Krahas këtij mekanizmi raportues, ne kemi udhëhequr bashkarisht dhe kemi marrur pjesë në Ekipin Ad Hoc për Minoritetet për mëse dy vite, duke e shfrytëzuar këtë forum të cilin e përbëjnë agjencitë e ndryshme si një mjet për të vënë në pah shqetësimet me të cilat përballen komunitetet minoritare si dhe gjetjen e zgjidhjeve adekuate si përgjigje e gjithë kësaj. Gjatë periudhës kohore kur është përpiluar ky raport, Ekipi Ad Hoc ishte i shpërndarë. Realiteti i tanishëm i cili mbretëron në Kosovë kërkon një qasje më komplekse dhe më gjithëpërfshirëse e cila nuk mundet të ofrohet nga një mekanizëm ad-hoc i shtyer nga vullneti i mirë. Në të ardhmen roli dhe funksioni të cilin do ta merr një ekip i tillë në rast nevojë, duhet të ndërrohet dhe zgjerohet nga UNMIK-u në formë të një Bordi Këshilldhënës për komunitetet vendore.

Edhe pse të vetëdijshëm për ndërlikueshmërinë në rritje dhe sensitivitetin i cili i rrethon çështjet që kanë të bëjnë me minoritetet dhe duke pasur në dijeni tendencën për të folur për komunitetet vendore në raport me minoritetet, ne kemi ruajtur strukturën dhe terminologjinë me të cilën janë punuar raportet paraprake. Kjo është bërë jo për shkak të pandjeshmërisë mirëpo më shumë për shkak të efikasitetit. Andaj, ne vazhdojmë që të përdorim termin minoritet, përderisa përdorimi i këtij termi i referohet çdo bashkësie e cila jeton në një situatë në të cilën ata për kah numri i tyre paraqesin pakicë në raport me bashkësitë të cilat i rrethojnë ata. Si i tillë, ky term është i aplikueshëm si për serbët e Graçanicës ashtu edhe për shqiptarët të cilët jetojnë në veri të Mitrovicës. Gjatë përpilimit të këtij vlerësimi edhe njëherë u bë e dukshme për që të dy organizatat të cilat punuan në këtë raport se bashkësitë e minoriteteve në Kosovë vazhdojnë të punojnë në mënyrë mjaft aktive në përcaktimin e fatit të tyre. Përpjekjet e bëra nga secili komunitet me qëllim të identifikimit dhe definimit të karakterit të tyre dhe kontributit të cilin ata duhet dhënë në kuadër të Kosovës janë përcaktuesit kryesor të ardhmërisë së tyre dhe si të tilla meritojnë një vëmendje të veçantë. Përkrahja e dhënë nga bashkëqytetarët e tyre, institucionet vendore si dhe bashkësia ndërkombëtare në përpjekjet e tyre për të përmbushur potencialin e tyre si anëtar të çmuar të shoqërisë, të lirë nga dhuna etnike, frikësimi dhe diskriminimi, mbetet një çështje kyçe në këtë aspekt. Asnjë shoqëri demokratike funksionuese nuk mund të shpresojë në qëndrueshmërinë e zhvillimit të saj duke mbajtur mbi supet e veta barrën e jotolerancës e cila si e tillë ende e karakterizon Kosovën. Sfidat e cila qëndron para nesh për të thyer këtë qark destruktiv dhe vetë-shtytës është se të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të punojnë në përbalimin

e gjendjes së krijuar nëse dëshirojnë të kenë një të ardhme të liruar nga padrejtësia e së kaluarës.

Përderisa gjendja e sigurisë mbetet brenga kryesore, ajo nuk paraqet faktor dominant sikurse ishte gjatë përpilimit të raporteve paraprake. Seria e sulmeve të dhunshme, të cilat kishin ndodhur diku kah fundi i periudhës kohore kur ishte përpiluar raporti i fundit, nuk është përsëritur më. Sidoqoftë, ne përsëri kemi paraqitur një sërë incidentesh të sigurisë, frekuenca e ndodhjes dhe pesha e të cilave tregojnë natyrën jo-stabile të gjendjes së përgjithshme në vend. Krahas incidenteve serioze të dhunës, stresi konstant i ndjenjës së nënçmimit dhe izolimit që është i pranishëm në kuadër të komuniteteve minoritare nuk duhet nënvlerësuar. Keqtrajtimet dhe frikësimet të cilat nuk përkojnë me shkallën e dhunës momentale paraqesin një mënyrë mjaft efektive për të penguar minoritetet në realizimin e të drejtave të tyre më themelore siç janë e drejta për të jetuar dhe përparuar në Kosovë në mënyrë të njëjtë sikurse edhe bashkëqytetarët tjerë pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Vështirësitë ekonomike, të cilat janë si rrjedhojë e paevitueshme e izolimit të prolonguar dhe bashkëveprimit të kufizuar gjithashtu kanë paguar çmimin e vet. Vjedhjet e bagëtisë dhe pajisjeve bujqësore kanë dalur në pah si një shqetësim primar për shumicën e bashkësive të minoriteteve të vendeve rurale. Aktivitetet e tilla kriminale të cilat kryhen kundër pakicave, të cilat nuk privojnë njerëzit nga jetërat e tyre mirëpo i privojnë nga baza egzistenciale, kohëve të fundit është duke u shiquar si një determinant për marrjen e vendimit nga ana e minoriteteve për ta lëshuar vendin përgjithmonë. Duke u mbështetur në shumë prej sfidave me të cilat janë duke u përballur minoritetet në Kosovë, ne gjithashtu kemi identifikuar një sërë shembujsh pozitiv të komunikimit ndëretnik dhe bashkëpunimit, të cilat i kemi përfshirë në këtë vlerësim me qëllim të ofrimit të një pasqyre më gjithëpërfshirëse të dinamikave dalluese të cilat i përshkojnë marrëdhëniet ndëretnike. Aktivitete relativisht të thjeshta siç janë mbledhjet e fshatit dhe mbledhjet në kuadër të lagjeve janë duke ndodhur dhe është e rëndësishme që të kihen në dijeni këta hapa tentativ drejt normalitetit në mënyrë që të kemi një sens më të mirë sa i përket realitetit mjaft të ndërlikuar i cili mbretëron në Kosovë. Bombat dhe të shtënat e zjarrit mund të vazhdojnë që të dominojnë nëpër titujt kryesor të gazetave mirëpo edhe përkundër këtij kthimi prapa, megjithatë janë duke u marrë masa të publicitetit të ultë dhe të mirëfillta të ndërtimit të mirëbesimit.

Gjatë kësaj periudhe kishin ngjarë shumë zhvillime të rëndësishme sa i përket kthimit të pakicave. Përderisa kthimi i tyre për momentin nëpër disa lokacione mbetet i pamundur për t'u realizuar për shkak të kanosjeve kundër sigurisë së tyre, një numër i lëvizjeve të shkallës së ulët, të cilat kanë ndodhur në kuadër të disa prej bashkësive të ndryshme të minoriteteve, japin shpresë për të ardhmen. Ekziston një sinqeritet në rritje e sipër nga ana e popullatës në përgjithësi për të diskutuar çështjen e kthimit por dhe inkurajues fakti megjithëse hezitues i pranimit nga disa pjesë të shoqërisë kosovare se kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur të cilët vijnë nga rradhët e minoriteteve nuk paraqet ndonjë kanosje për kosovarët por, ajo më shumë paraqet realizim të drejtave të tyre më elementare. Do të ishte papjekuri nëse entuziazmohemi për progresin e arritur përkritazi me kthimin e tyre pa e njohur plotësisht faktin se pjesëtarët e minoriteteve vazhdojnë të lëshojnë Kosovën të bindur se nuk kanë ardhmëri të qëndrueshme në Kosovë sidomos në planin afatgjatë. Kthimet dhe shkuarjet janë jetësisht të ndërlidhura në mes veti dhe çdo studim objektiv lidhur me gjasat e kthimit duhet t'i kushtojë rëndësi kushteve tejet të vështira me të cilat përballen shumica e komuniteteve minoritare.

Duke pasur parasysh ndërrimet tejet të mëdha të cilat kanë ndodhur në Kosovë që kur OSBE-ja dhe UNHCR-ja për herë të parë themeluan këtë mekanizëm të raportimit në verën e vitit 1999, çdo analizë serioze e realitetit të karakterit multi-etnik i cili mbretëron në Kosovë duhet të shkojë përtej imazhit të jashtëm të një shoqërie të ndarë si rezultat i konfliktit ndëretnik, dhe të vlerësojë kompleksitetet e brendshme të cilat shtyejnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Ne kemi potencuar shumë prej çështjeve tematike të cilat kanë qenë të përfshira në raportet paraprake duke u munduar që t'ju ofrojmë informata të reja sa i përket ndonjë përparimi eventual të rëndësishëm në këtë drejtim apo ndonjë kthimi prapa në këtë proces gjatë periudhës kohore kur është përpiluar ky raport. Liria e lëvizjes për shumicën e bashkësive të minoriteteve mbetet të jetë e brishtë. Gjithashtu, qasja në shumicën e shërbimeve elementare mbetet problematike përkundër pranimit në rritje nga ana e disa ofruesve të shërbimeve për sfidat me të cilat ata duhet

të përballen me përpjekjet për t'i kryer detyrimet e tyre me ofrimin e shërbimeve të barabarta të gjithë shfrytëzuesve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Ne gjithashtu kemi vërejtur përpjekje të shtuara nga ana e UNMIK-ut dhe të tjerëve për të sajuar disa prej solucioneve të përshtatshme, mirëpo gjithashtu kemi vërejtur se përpjekjet e shtuara dhe burimet materiale të cilat kërkohen për to, vazhdojnë të paraqesin një pengesë të dukshme për një përparim të qëndrueshëm në këtë drejtim.

Ne kemi për qëllim të jemi të drejtëpërdrejt si dhe të prezentojmë informatat në mënyrë të hapur, duke theksuar aspektet e shqetësimeve si dhe deri në një shkallë të mundur të sugjerojmë solucione të realizueshme. Përderisa Kosova është duke ecur drejt edhe një caku në kuadër të zbatimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit me zgjedhjet për kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 17 nëntor 2001, shpresohet se ky raport do të shërbejë si një orientim dhe një mjet për të gjithë ata të cilët janë të shqetësuar me gjendjen me të cilën përballen minoritetet. Kjo çështje kërkonte kohë dhe gjatë mbledhjes së informatave dhe fazave nëpër të cilat ka kaluar përpilimi i këtij raporti, ka qenë mjaft me rëndësi për akterët vendor sidomos sa i përket zhvillimit të një shoqërie civile. Vetëm kosovarët janë ata të cilët mund të formësojnë një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Udhëzimet dhe përkrahja të cilën është duke e dhënë bashkësia ndërkombëtare në këtë drejtim janë të pazëvendësueshme mirëpo, në fund të fundit, sfida qëndron para çdo kosovari për të përçafuar mundësinë e cila i'u është dhënë për arritjen e një ardhmërie më të mirë dhe ndihmën që duhet dhënë ata njëri tjetrit me qëllim që ta arrijnë këtë. Bashkësitë e minoriteteve nuk duhet të shiqohen si viktime pasive të agresionit, sikurse që edhe komuniteti shumicë si i tërë nuk duhet të perceptohet si agresor. Në vend të kësaj, duhet të fokusohemi më shumë në të drejtat dhe obligimet të cilat duhet t'i ketë çdo banor i Kosovës për të punuar bashkarisht në mënyrë të paanshme dhe me mendjehapësi drejt realizimit të qëllimit për një Kosovë paqësore për të cilën ata kanë aspiratë.